



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 572/3 prot.

Tiranë, më 24.03.2023

**NJOFTIM ME SHPALLJE**

**TË VENDIMIT NR. 572/1, DATË 15.03.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, "PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË ANKESËS SË PARAQITUR NGA SHTETASJA ZNJ. INGRID GOXHAI NË LIDHJE ME VEPRIMTARINË E ISH MAGJISTRATËVE Z. F.Q., DHE Z. M.S., SI DHE ARKIVIMIN PAS VERIFIKIMIT TË ANKESËS SË PARAQITUR NGA SHTETASJA ZNJ. INGRID GOXHAI NË LIDHJE ME MAGJISTRATEN ZNJ.E.S."**

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e znj. Ingrid Goxhaj me nr. 470 prot., datë 02.02.2021, ndaj veprimtarisë së magjistrates znj. F.D., gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe znj. E.S., z. F.Q., dhe z. M.S., gjyqtarë në Gjykatën e Apelit Tiranë në kohën kur ka ndodhur shkelja e pretenduar dhe me vendimin nr. 572/1, datë 15.03.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për përfundimin e procedurës së verifikimit të ankesës së paraqitur nga shtetasja znj. Ingrid Goxhaj në lidhje me veprimtarinë e ish magjistratëve z. F.Q., dhe z. M.S., si dhe arkivimin pas verifikimit të ankesës së paraqitur nga shtetasja znj. Ingrid Goxhaj në lidhje me magjistraten znj. E.S", bazuar nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative nenin 122 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t'i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Tiranë, Njësia Bashkiake nr. 1, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Rruga: "Dervish Hima", Kulla nr. 2, Shk. 1, Kati 8, Ap. 19;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: [www.ild.al](http://www.ild.al).

Shpalljet që do të afishohen në ambientin e bashkisë përkatëse, do të hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

**Dëshira Pasko**

